



Asociacioni i Komunave të Kosovës

MANUALI UDHËRRËFYES PËR KONSULTIME PUBLIKE



Qershor 2007

Mbështetur nga:



"Pikëpamjet e autorëve, të shprehura në këtë publikim, nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara".

Përmbajtja:

1) Kush është AKK-ja.....	5
2) Hyrje.....	8
3) Qëllimi i Manualit.....	9
4) Rëndësia e konsultimit publik.....	9
5) Si të arrihet suksesi gjatë konsultimit të publikut.....	11
6) Infrastruktura ligjore për konsultime publike.....	13
7) Tubimet publike.....	15
8) Përgjegjësit dhe detyrat e zyrtarëve lokal për procesin vendimmarrës	20
9) Rezultatet e mundshme të konsultimit publik.....	23
10) Vendimmarrja.....	25
11) Shtojca - Parimet e qeverisjes së mirë.....	26

1. Kush është AKK-ja

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është formuar me 26 janar 2001 në mbledhjen e parë të Kuvendit të AKK-së pas zgjedhjeve të para demokratike komunale në Kosovën e pasluftës.

Themelimi i Asociacionit të Komunave të Kosovës është mbështetur në nenin 10 të Kartës Evropiane të Autonomisë Lokale në kuadër të Këshillit të Evropës (e drejta për asociacion), ne gjithashtu shohim nevojën për të qartësuar kompetencat në fusha të ndryshme dhe të forcojmë marrëdhëniet mes nivelit komunal dhe atij qendror.

AKK-ja është organizatë jopfitabile, është person juridik që i përfaqëson interesat e përgjithshme të anëtarëve të saj - autoritetet lokale.

Anëtarë të Asociacionit janë autoritetet lokale të Kosovës. Autoritetet lokale anëtarësohen në Asociacion nga Kuvendi i Asociacionit pas vendimit të marrë në Kuvendin Komunal.

AKK-ja angazhohet që në Kosovë të implementohen rregullat nga Karta Evropiane për qeverisjen lokale, të organizoj dhe koordinoj aktivitetet e anëtarëve të saj në sferën e investimeve, në zhvillimin ekonomik të komunave, në përmirësimin e bazës ligjore, të përkrahjes së biznesit, në preventivë dhe kundër krimit, në kulturë, arsim, shkencë, mbrojtje shëndetësore, në çështje sociale dhe përkrahjes sociale, në zgjidhjen e konflikteve, në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në raportet me Asociacionet simotra jashtë shtetit dhe me organizatat ndërkombëtare.

Objektivat e AKK-së

1. Asociacioni i Komunave të Kosovës është interes i përbashkët i participuesve për kushtet dhe rrethanat në të cilat vepron.
2. Asociacioni ka karakter profesional e asesi politik, me obligim të demokratizimit të mëtutjeshëm të shoqërisë kosovare.
3. Asociacioni do të jetë organizëm i fortë midis pushtetit lokal dhe atij qendror, duke i mbrojtur përshtur kompetencat e komunave nga tendencat centraliste si dhe duke i avansuar ato në harmoni me aktet në fuqi (Rreg.2000/45).
4. Asociacioni, përveç demokratizimit të shoqërisë (përmes demokratizimit të institucioneve), do të punojë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, forcimin

e bashkëpunimit mes komunave si dhe në integrimin e komuniteteve në shoqërinë kosovare.

5. Objektiv kryesor i këtij Asociacioni do të jetë qeverisja e mirë dhe e suksesshme në nivelin lokal, duke i dalë zot përgjegjesisë së dhënë në të gjitha fushat shoqërore që i përkasin.

6. Asociacioni do të ketë synim harmonizimin e niveleve të ndryshme të qeverisjes si dhe flakjen e paralelizmave të panevojshme, pavarësisht nga adresohen.

7. Asociacioni do të bashkëpunojë dhe aderojë me asociacionet simotra evropiane - ndërkombëtare si dhe do të bazohet në Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale (neni 4, artikulli 6) ku thuhet: bashkësive lokale duhet t'u kërkohet mendimi, Brenda mundësive, në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme, gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për çështjet që u përkasin drejt-përsëdrejti, duhet respektuar

AKK-ja në planin ndërkombëtar:

AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës.

Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës JugLindore).

Poashtu është në pozitën Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR).

Asociacioni ka kooperim shumë të ngushtë me si dhe ka ngritur një bashkëpunim të mirë me Asociacionet dhe Autoritetet lokale Rajonale.

KOLEGJIUMET E ASOCIACIONI TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

Asociacioni i Komunave të Kosovës në kuadër të strukturave të veta vepruese ka të formuara dhe funksionale 9 (nëntë) Kolegjiume profesionale që merren me aspekte të ndryshme të qeverisë lokale e të cilat përbëhen nga përfaqësuesit e komunave të Kosovës.

Qëllimi i formimit të Kolegjiumeve nga AKK-ja është të paraprijë në përgatitje për të përballur nevojat afat shkurta dhe afat gjata, të evidentoj praktikat më të mira për ti eliminuar ato jo korrekte, të ruaj burimet e vlefshme të pushtetit lokal, të ndihmojë në analizimin e çështjeve të pushtetit lokal, me qëllim të funksionimit të shërbimeve cilësore komunale.

Kolegjiomet e AKK-së funksionojnë në përbërje prej të gjitha komunave të Kosovës. Qëllimet e tyre mund të jenë të ndryshme por parimet, synimet organizative të tyre janë mjaft të qëndrueshme.

Kolegjiomet ofrojnë koordinim të punëve dhe praktikave të mira për të gjitha komunitat, duke filluar nga qasja në problemet nga aspekt më të gjerë, realizojnë strategji për shërbime komunale, punojnë në evidentimin e një niveli të administrimit që ka mangësi por që mund të përmirësohet, angazhohen në përmirësimin e gjendjes së krijuar legislative duke nxitur praktika vete-reflektive brenda nivelit lokal duke vlerësuar situatat për fushat e përzgjedhura, promovojnë bashkëpunimin ndër komunal, asistojnë në identifikimin e nevojave të trajnimeve, sigurojnë forum për këmbim të praktikave të mira duke i institucionalizuar shkëmbimet e eksperiencave dhe vlerësimet e përbashkëta me qëllim të rezultimit të zbatueshëm në kushte reale.

Kolegjiomet e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe struktura organizative:

- Kolegjiomi i Kryeshefave të Ekzekutivit
- Kolegjiomi i Drejtorëve të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Kolegjiomi i Drejtorëve Inspektues Komunal
- Kolegjiomi i Drejtorëve të Shërbimeve Publike
- Kolegjiomi i Drejtoreve të Planifikimit Hapësinor
- Kolegjiomi i Drejtoreve të Zhvillimit Ekonomik Lokal
- Kolegjiomi i Drejtoreve të Administratës së Përgjithshme
- Kolegjiomi i Zyrtarëve Ligjor
- Kolegjiomi i Zyrtarëve për Integritet Evropian

2. Hyrje

Ky manual është përpiluar dhe dizajnuar në funksion të përshkrimit të procesit konsultativ publik me qëllim të demokratizimit dhe qëndrueshmërisë së proceseve vendim-marrëse. Njëkohësisht përmes zërthimit të konceptit të konsultimit publik shtjellohen në detaje instrumentet dhe mekanizmat që ndihmojnë këtë proces. E dimensionuar në dy nivele, procesi i konsultimit publik sa është në funksion të qeverisjes së mirë të autoriteteve lokale (shih shtojcën) do të ndihmon edhe edukimin dhe motivimin e qytetarëve për pjesëmarrje aktive në komunën tuaj. Do të ju ofron informatat themelore të cilat ju duhen që të jeni pjesë e proceset vendimmarrëse komunale.

Në manual përshkruhet edhe infrastruktura ligjore e aplikueshme sot në Kosovë që obligon autoritet lokale për zbatim dhe respektim korekt duke garantuar mundësinë e ndikimit të publikut përmes pjesëmarrjes në procesin e konsultimit lokal mekanizmave dhe instrumenteve të formuara apo që duhet të formohen.

Për një qeverisje të mirë është domosdoshmëri pjesëmarrja aktive e qytetarëve në të gjitha fazat e procesit vendimmarrës duke filluar nga planifikimi, diskutimi, vendimi, implementimi dhe monitorimi.

Pjesëmarrja e publikut në procesin e konsultimit ka një histori të gjatë dhe shpjegohet nga shumë teori. Por të gjitha këto kanë një emërues të përbashkët që është se qeverisja e mirë dhe shoqëria civile e shëndoshë varet nga ajo se sa individ apo komuniteti është aktiv në paraqitjen, mbrojtjen e interesit individual dhe publik.

Realizimi i rolit të qytetarit aktiv është shprehur në mënyra të ndryshme dhe shpeshherë në vendet në tranzicion ka mbetur në stadin e iniciativës apo tentativës. Me grupimin e individëve në shoqata apo organizata që i bashkon interesi i përbashkët, roli i qytetarit fillon të jetë shumë më i madh, fiton në relevancë dhe merret në konsideratë duke promovuar interesin publik gjegjësisht të komunitetit karshi atij individual-privat.

Është e pranueshme se ushtrimi i autoritetit qeverisës nuk nisë dhe përfundon

vetëm me marrjen e vendimeve por është shumë më i gjerë, nënkupton procesin e vazhdueshëm përfshirë nivelin e informimit-komunikimit me qytetarë si parakusht për konsultim të qëndrueshëm dhe funksional duke siguruar involvimin dhe rolin aktiv të publikut në procesin vendimmarrës.

Puna e përbashkët dhe partneriteti publik me organizatat, shoqatat, grupet e interesit krijon ambientin e përshtatshëm për konsultim aktiv të publikut, duke reflektuar drejtëpërdejt në kohën, kualitetin dhe qëllimin e vendimmarrjes.

3. Qëllimi i Manualit

Ky manual është hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Manuali është i dobishëm për të zgjedhurit lokal dhe administratat e tyre. Manuali synon që të shërbejë si referencë e mundshme për të gjithë qytetarët që janë të interesuar për të qenë pjesë e vendimmarrjes.

Përfituesit nga përdorimi i manualit do të jenë kryesisht:

- Të zgjedhurit në organet e qeverisjes lokale, në funksion të prezantimit të njohurive të nevojshme në lidhje me marrjen e vendimeve me pjesëmarrje të gjerë,
- Punonjësit e administratës në organet e qeverisjes lokale në tërësi dhe, në veçanti të atyre që angazhohen drejtëpërdrejtë me realizimin e vendimeve të pushtetit lokal,
- Qytetarët me aktiv, me synim të njohin më mirë rregullimet ligjore dhe procedurat përkatëse mbi pjesëmarrjen e publikut.

4. Rëndësia e procesit të konsultimit publik

Pushteti komunal gjegjësisht komunat janë të krijuara për të shërbyer qytetarët. Ato bëhen më të fuqishme dhe atraktive kur qytetarët marrin pjesë në vendimmarrje. Vendimet e marra nga qeveria e juaj lokale prekin jetën e përditshme të qytetarëve dhe patjetër që meriton vëmendjen e tyre.

Vendimet e marra për buxhetin vjetor, transportin publik, grumbullimi i mbe-

turinave, planet urbane, funksionimi i shërbimeve shëndetësore, hapja e shkollës, furnizimi me ujë të pijes, ngrohja, detyrimisht afektojnë buxhetin dhe mirëqenien e qytetarit.

Si qytetarë dhe taksapagues, ata në vazhdimësi duhet të njoftohen, informohen në kohë dhe me të gjitha mënyrat e mundshme duke siguruar konsultimin dhe bashkëpunimin reciprok me të cilën ndërtohet bashkëpërgjegjësia dhe transparenca e vendimmarrjes si kusht i respektimit dhe qëndrueshmërisë së gjithë procesit vendim-marrës. Kjo ndihmon edhe në ndërtimin dhe zhvillimin e masës kritike dhe opinionit publik për vendimet e pushtetit komunal.

Janë disa mundësi për publikun se si të involvohet dhe të bëhet pjesë aktive në proceset vendimmarrëse. Në disa raste zyrtarët komunal mirëpresin kontributin vullnetar të publikut, por në shumë raste ata janë të detyruar me ligje që të konsultojnë mendimin dhe të marrin pajtimin e qytetarit.

Sido që të jetë, Kuvendi Komunal është ai që ka autoritetin dhe të drejtën për të marrë vendimet e plotfuqishme. Por për pushtetin që pretendon suksesin dhe korrektësin e vendim-marrjes është më se e domosdoshme të ketë ndërtuar kapacitete dhe resurse që sigurojnë informimin e drejtë, transparent dhe gjithpërfshirës në të gjitha format e mundshme ku publiku ka qasje.

Është në trend që shumë komuna në Kosovë kanë faqet e internetit ku prezantojnë vendimet e tyre, përdorin tabelat zyrtare të vendosura në ndërtesat komunale, pa analizuar në detaje se sa është numri i qytetarëve që kanë qasje në internet apo vizitojnë këto objekte. Është në interesin e pushtetit lokal që me veprime konkrete, praktike të demonstrojnë gatishmërinë e tyre për informim të mirëfilltë dhe jo vetëm formal duke ndërtuar raporte dhe kanale komunikimi me publikun.

5. Si të arrihet sukcesi gjatë konsultimit publik

Nëse dëshironi të keni rezultate sa më të mira nga procesi i konsultimit publik duhet që zyrtarët e pushtetit lokal të përgatisin paraprakisht planin e veprimit me të gjitha detajet që sigurojnë qëllimin, kohën, vendin, mjetet dhe grupet qëllimore që do të konsultohen. Është e kuptueshme se përgaditjes së planit të veprimit i paraparin puna hulumtuese dhe analitike e problematikes që do të shtjellohet në procesin e konsultimit publik, definohet qëllimi dhe përcaktohen objektivat dhe rezultatet e procesit duke integruar instrumentet dhe resurset e nevojshme.

Përkufizimi i qëllimit dhe objektivave të konsultimit publik, determinon edhe numrin dhe natyrën e aktiviteteve, kohëzgjatjen, akterët që duhet të involvohen, partnerët e mundshëm dhe burimet e nevojshme.

Orientimisht, i gjithë ky proces mund të evaluohet përmes tabelës që do të prezantohet më poshtë si shembull:

Qëllimi: Të organizohet konsultimi publik për planifikimin e zhvillimit ekonomik në komunën X.				Implementon: Kuvendi Komunal X Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Përgjegjësi: X.X			
1. Objektivi	Rezultatet	Aktivitetet	Akterët	Kohë-zgjatja	Vendi	Përgjegjësi	Buxheti
Analizimi i situatës aktuale ekonomike në komunë	Informimi dhe krijimi i bazës së shënimeve për situatën ekonomike të bazuar në fakte dhe evidencë.	1.1 Përgaditja e një pyetësoi 1.2. Shpërndarja dhe plotësimi i pyetësoi 1.3. Evaluimi dhe analiza e pyetësoi	OEK Biznesi privat NVM Shoqatat e prodhuesve Zyrat e tatimit Bankat	4 javë, (shumë e detajuar)	Qyteti Lokacioni	Emërtohen me emër dhe pozita	Totali
2. Objektivi Organizimi debateve dhe punëtorive konsultative	Involvimi i të gjithë akterëve relevante në planifikim e zhvillimit ekonomik	1.Organizimi 4 debateve. 2.Organizimi 2 punëtorive	1.Fabrika e telave 2.X.X 3.Y.Y 4.Z.Z 5. 6.	2 muaj	Qyteti Lokacioni	Emërtohen me emër dhe pozita	Totali

Për një proces konsultues të suksesshëm, angazhimi i publikut duhet të bëhet nëpër këto faza:

A. Hulumtimi dhe Informimi i publikut- Grumbullimi i të dhënave përmes qasjes siç është hulumtimi i opinionit. Këtu nuk ka dialog midis autoriteteve lokale dhe publikut. Zakonisht publiku merr pjesë si individ.

B. Kominikimi dhe Konsultimi- një dialog i kufizuar që shkon drejt diskutimit të politikës apo çështjes së caktuar. Metodatat e përdorura shkojnë nga grupet e fokusit deri te komitetet këshilluese të qytetarëve. Këtu njerëzit vijnë bashkë si përfaqësues të grupeve të caktuara të komunitetit. Duhet të jetë visibël, gjithëpërfshirës për të gjithë aktorët relevantë për çështjen duke siguruar së çdo banorë apo qytetarë për çështjen që diskutohet mund të jep mendimin dhe qëndrimin personal ¹.

C. Pjesëmarrja- autoritetet lokale duhet që të krijojnë hapësirë të pjesëmarrjes për të gjithë aktorët relevantë në procesin vendimmarrës. Është një dialog në vazhdimësi midis autoriteteve dhe publikut, zakonisht për një varg çështjesh. Forumet komunale për debat mund të jenë shembulli më i mirë.




Fig. 2 Fazat e procesit vendimmarrës në bazën e konsultimit publik

1. Zakonisht janë grupe apo organizata të komunitetit që janë familjar me çështjet e ndryshme të qeverisjes lokale. Ato në Kosovë kanë statusin e OJQ-ve.

D. Rezultatet e Konsultimit- nga debate dhe diskutimi me pjesëmarrje aktive me qytetarë, rezultojnë alternativat më të mira për zgjidhjen e problemeve apo planifikimet më të drejta strategjike zhvillimore. Të gjitha komentet, sugjerimet sistemohen dhe duhet të reflektojnë në propozim vendimet përpara se të vendoset nga ana e autoriteteve lokale.

E. Vendimmarrja- me një konsultim publik gjithëpërfshirës paraprak, vendimmarrja gjithmonë do të jetë më e lehtë, më racionale, alternativa më e mirë, dhe në të shumtën e rasteve merret me konsensus të plotë nga vendimmarrësit.

F. Implementimi dhe Monitorimi- vendimi i marrë nga vendimmarrësit në kohën e caktuar të fuqizimit kërkon planin, instrumentet dhe mekanizmat që sigurojnë zbatimin dhe respektimin në praktikë, Normalisht që kësaj faze duhet ndërtuar planin e monitorimit të vazhdueshëm të implementimit.

Njëkohësisht qytetari ka mundësi të informohet dhe të edukohet se kontributi dhe mendimi i tij është me interes dhe relevant për procesin vendimmarrës. Angazhimi dhe involvimi i qytetarit prej fillimit dhe sa më herët është qasja më e mirë.

6. Infrastruktura ligjore për konsultime publike

Trashëgimia nga regjimi i kaluar, e kombinuar me ndryshimet radikale të tranzicionit, e kanë bërë një pjesë të madhe të popullatës indiferente karshi qeverisjes. Mungesa e kapaciteteve, përvoja e vogël, administrata jofunksionale, mungesa e zbatimit dhe respektimit të ligjit, mungesa e transparencës janë pjesë e imazhit të perceptuar nga ana e publikut për autoritete qeverisëse.

Në funksion të përmirësimit dhe rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në qeverisje, pjesëmarrja e publikut në konsultime krijon te komuniteti i involvuar ndjenjën e bashkëpërgjegjësisë dhe pronësisë në procesin vendimmarrës.

Kur qytetarët e ndjenjë se ata janë pronarë të procesit, niveli i mbështetjes për çdo vendim gjatë procesit si të planifikimit apo implementimit ngrihet në mënyrë të pabesueshme.

Sigurimi i mbështetjes nga komuniteti me bazë të gjerë për iniciativat e pushtetit apo administratës shtetërore është jetike për qëndrueshmërinë e këtyre iniciativave. Këtu përfshihen përpjekjet e ndërmarra për realizimin e mbështetjes politike midis zyrtarëve dhe drejtuesve të tjerë me influencë në komunitet.

Pjesëmarrja shkon përtej konsultimit të përfaqësuesve shtetëror me njerëzit lokalë dhe nënkupton angazhimin e hershëm dhe të përbashkët me sektorin publik vendimmarrës.

Shkurtimisht "pjesëmarrja" në kontestin e pushtetit duhet të synojë ndërtimin e "kapitalit social" dhe të cilësive për një komunitet për të punuar bashkërisht.

Elementet që nevojiten për të siguruar një mobilizim të suksesshëm të komunitetit:

- Qytetarët e interesuar të gatshëm për të mbajtur një qëndrim, thonë se ata duan një ndryshim dhe se janë të gatshëm të punojnë për realizimin e tij;
- Udhëheqje që frymëzon dhe drejton procesin;
- Një vizion i përbashkët i komunitetit mbi rezultatet;
- Njerëz të përfshirë që pranojnë se mjetet për arritjen e qëllimeve të tyre janë të ndryshme, por ata mbështesin qëllimin e përbashkët;
- Njohja dhe inkurajimi i atyre që ndihmojnë për arritjen e qëllimit;
- Plane dhe qëllime specifike për uljen e ndikimit për situata me rrezik;
- Udhëheqje që inkurajon, ndërton dhe zhvillon strategji, por që nuk vendoset në qendër të situatës;
- Edukimi i qytetarëve.

Sot në Kosovë presioni më i madh nga qytetarët bëhet ndaj komunave dhe komunikimi i komunës me qytetarët bëhet sipas Rregullorës së UNMIK-ut 2000/45 ku gjatë vitit parashihen më së paku dy tubime publike me qytetarët gjithashtu janë të aprovuara në disa komuna edhe disa rregullore mbi participimin apo pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimarrjes.

Përveç Rregullores 2000/45 gjithashtu edhe statutet e komunave parashohin apo rregullojnë raportet midis qytetarit dhe pushtetit lokal gjegjësisht komunave ku parashihet peticioni, pastaj e drejta për qasjen në dokumenta nga qytetarët e të

tjera. Këto mekanizma në komuna qytetarët pjesërisht i shfrytëzojnë edhe atë me iniciativë të shoqërisë civile gjegjësisht organizatave joqeveritare.

Karakteristikë tjetër është se udhëheqësit komunal pak vizitojnë fshatrat dhe bashkësitë lokale në qytet dhe në njëfarë mënyre edhe kjo e sforcon vakumin në komunikim mes pushtetit dhe qytetarit. Komunikimi i pushtetit lokal me qytetarët në dallim me pushtetin qendror është i kënaqshëm. Fushatat avokuese dhe lobuese kanë filluar në këto dy vitet e fundit dhe ato kryesisht udhëheqën nga organizatat joqeveritare. Pra organizatat joqeveritare -OJQ-të janë bërë ura kryesore komunikuese në mes pushtetit lokal dhe qytetarëve.

7.Tubimet publike

Qeveria Komunale është e obliguar që të organizojë "tubime publike" në të cilat janë të ftuar të gjithë pjesëtarët e publikut. Në këto tubime, përfaqësuesit e komunës e njoftojnë publikun lidhur me veprimtaritë, politikat dhe planet e komunës.

Pjesëtarët e publikut mund të shtrojnë pyetje, t'i paraqesin shqetësimet e tyre, t'i diskutojnë çështjet me interes për komunitetin, si dhe t'u bëjnë propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me veprimtaritë dhe përgjegjësitë e qeverisë komunale.

Konsultimet publike apo tubimet publike në nivelin komunal i rregullon Rregullorja 2000/45 neni 8 ku në mënyrë të qartë definohet si vijon:

8.1 Çdo komunë duhet të organizojë tubime periodike publike, së paku dy herë në vit, ku të cilat të gjithë njerëzit apo subjektet e interesuar në komunë mund të marrin pjesë. Data dhe vendi i tubimit publikohen së paku dy javë para takimit. Në tubim, përfaqësuesit e komunave i informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e komunës dhe pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe t'u japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal.

8.2 Çdo person apo organizatë që ka interes në komunë ka të drejtë t'i paraqesë petition Kuvendit Komunal për çfarëdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Kuvendi Komunal e shqyrton petitionin në pajtim me Statutin dhe rregullat procedurale të tij.

Është po ashtu fakt se edhe aktet ligjore si Statuti i komunës gjithashtu në mënyrë shumë të qartë e definojnë pjesëmarrjen e publikut në tubimet publike dhe në përgjithësi pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimarrjes në komuna. Janë disa shembuj në Kosovë, ku autoritetet lokale me iniciativën e organizatave joqeveritare kanë aprovuar edhe nën akte ligjorë që definojnë inkurajojnë dhe garantojnë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Shembull është aprovimi i një rregullore në vitin 2002 nga: Kuvendi Komunal i Gjakovës të emërtuar si "*Rregullore për Zbatimin e Dispozitave të Statutit të Komunës së Gjakovës për Konsultim dhe Pjesëmarrje të Publikut (Neni IV)*". Kuvendi Komunal i Gjakovës miraton këtë rregullore me qëllim të zbatimit të dispozitave përkitazi me konsultimin dhe pjesëmarrjen e publikut të parashtruara në Statutin e Komunës së Gjakovës dhe në Rregulloren 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunale në Kosovë, si dhe me qëllim të garantimit të të drejtave të qytetarëve që të informohen dhe të marrin pjesë në qeverinë e tyre. Kjo rregullore u miratua edhe në disa komuna tjera të Kosovës .

Në Kosovë ekzistojnë shumë mundësi në rritjen e komunikimit me qytetarë duke u bazuar edhe në infrastrukturën ligjore ekzistuese por edhe mundësinë e plotësimit dhe avancimit të kësaj infrastrukture sidomos në krijimin e mekanizmave apo instrumenteve të qëndrueshëm që e inkurajojnë këtë komunikim.

Elementet që rrezikojnë nivelin dhe kualitetin e konsultimit publik mund të kategorizohen si korrupsioni, mungesa e transparencës, mungesa e llogaridhënies në menaxhimin e parasë publike, joprofesionalizimi në punë të cilat drejtpërdrejt demotivojnë akterët e komunitetit të marrin pjesë aktive në proceset vendimmarrëse.

Janë disa veprime që duhen marrë në konsideratë që nga ideja, planifikimi dhe organizimi i tubimeve publike, si:

Cili është qëllimi i ftesës për publikun për t'u takuar me përfaqësuesit e qeverisë komunale?

Publiku i informuar dhe i angazhuar është vendimtar për procesin demokratik. Zyrtarët e zgjedhur mund ta përfaqësojnë më mirë publikun nëse ata janë

vazhdimisht të informuar lidhur me shqetësimet, idetë dhe ankesat e komunitetit. Nga ana tjetër, publiku mund të ndikojë në mënyrë më të efektshme në vendimet e qeverisë, nëse ai di se me çfarë çështjesh ballafaqohet qeveria.

Tubimet publike të publikut dhe përfaqësuesve të tij të zgjedhur mundësojnë zhvillimin e debatit dhe të shkëmbimit të ideve gjë e cila mban të gjallë procesin demokratik. Mbajtja e tubimeve publike siguron që qeveria të punojë në mënyrë transparente dhe që qytetarët të mund të marrin pjesë në mënyrë të përgjegjshme në vetëqeverisjen e tyre.

Përveç kësaj, propozimet, pyetjet, idetë dhe ankesat që shtrohen në tubimet publike do të shqyrtohen në formë të shkruar në Komitetin për Politikë dhe Financa të Asamblesë Komunale, dhe i cili pastaj del me rekomandime para Asamblesë. Kështu që idetë e diskutuara në tubimet publike do të shqyrtohen zyrtarisht nga Zyrtarët e zgjedhur, me ç'rast mund të vijë deri te ndryshimi i politikave dhe programeve të qeverisë. Së fundi, qytetarët që marrin pjesë në tubimet publike do të kenë rast të njihen me qytetarë të tjerë në komunitet me të cilët i lidhin shqetësimet e përbashkëta dhe mund të formojnë rrjete për avokim më të efektshëm të çështjeve.

Çfarë çështjesh diskutohen në tubime publike ?

Çdo çështje që ka të bëjë me përgjegjësitë e komunës mund të diskutohet në tubime publike. Qytetarët mund të jenë të interesuar të diskutojnë për rregulloret në shqyrtim ose të miratuara nga Kuvendi Komunal; funksionimin e shërbimit civil ose të qeverisë komunale; çështjet që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve komunale, mbledhjen e mbeturinave dhe rrugët; infrastrukturën e shkollave; rregullat për tenderë dhe ofertim të kontratave me qeverinë ose për buxhetin komunalë.

Kush mund të marrë pjesë në tubim publik?

Çdokush që ka interesim për komunën mund të merr pjesë. Qytetarët privatë, përfaqësuesit e mediave, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësues nga sektori i biznesit, unionet e ndërmarrëseve, sindikatat, grupet vullnetare, shoqatat profesionale, etj.

Sa shpesh duhet të mbahen tubimet publike?

Çdo komunë është e obliguar që të mbajë të paktën dy tubime publike në vit. Njëri nga këto tubime duhet të mbahet gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit fiskal të komunës, ndërsa një tjetër duhet të mbahet gjatë gjashtëmuorit të mbetur të vitit fiskal të komunës. Nëse gjatë vitit fiskal të komunës janë mbajtur vetëm dy tubime publike, atëherë duhet doemos të lihet një periudhë dymujore ndërmjet këtyre dy tubimeve.

Ku do të mbahen tubimet publike?

Statutet parashohin që tubimet të mbahen në një vend me hapësirë të mjaftueshme për t'i zënë të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të marrin pjesë në këto tubime. Normalisht që duhet të sigurohet qasje e lehtë dhe komoditetet në vendet ku mbahen tubimet publike.

Si do ta dinë qytetarët se kur dhe ku mbahet tubimi publik?

Koha, data dhe lokacioni i çdo tubimi publik do të shpallet nga Kuvendi Komunal dy javë para mbajtjes së tubimit. Ky informacion do të publikohet në mediat lokale dhe do të afishohet si njoftim në ndërtesën e komunës. Tubimet publike nuk do të mbahen në data ose termine të papërshtatshme për publikun e gjërë ose për komunitetet e caktuara.

Kush do t'i udhëheqë tubimet publike?

Tubimet publike do t'i udhëheqë Kryesuesi, ose përfaqësuesi i tij, ose i saj. Ai, ose ajo ka kompetenca për t'i caktuar procedurat që duhet ndjekur gjatë tubimeve, e me të cilat rregullohen çështjet si kush flet në tubim, sa gjatë mund të flitet dhe cilat tema do të trajtohet.

A do të lejohen të gjithë të flasin dhe të bëjnë pyetje për tubimet publike?

Kryesuesi ka kompetenca për të ndaluar diskutimin e çështjeve që nuk kanë të bëjnë me përgjegjësitë komunale, ose me punën e komunës. Ai ose ajo mund të

mos i ftojë që ta marrin fjalën ose t'i dëgjojë folësit të cilët shprehin mendime të ngjashme ose të përsëritura. Ai ose ajo mund të caktojë gjithashtu një kufizim kohor të kohëzgjatjes së fjalimeve.

Me anë të kompetencave që ka Kryesuesi për t'ia kufizuar folësit kohëzgjatjen e fjalimit, ose për t'i ndërprerë fjalimet përsëritëse, shmanget mundësia që një person ose një temë të mbizotërojë në tërë tubimin dhe që një gamë e gjërë e çështjeve me interes të mund të trajtohet nga individë të ndryshëm.

Kjo kompetencë duhet të ushtrohet duke e pasur parasysh se tubimet publike janë forum i cili ka për qëllim inkurajimin e pjesëmarrjes publike. Individët që duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë për pjesëmarrje publike në mënyrë të përgjegjshme, në mënyrë që tubimet të jenë në shërbim të shkëmbimeve të dobishme të informacioneve dhe ideve.

Çka ndodhë nëse një qytetar bënë ndonjë pyetje ose kërkon informacione të cilave qeveria nuk është në gjendje t'u japë përgjigje?

Në rast se në një tubim publik parashtrohet ndonjë pyetje në të cilën qeveria nuk është në gjendje të japë përgjigje gjatë tubimit, personi që ka parashtruar pyetjen ka të drejtë që brenda 30 ditësh nga përfundimi i tubimit të kërkojë nga qeveria përgjigje me shkrim në pyetjen e tij.

Si mundet një qytetar të mësojë se çka është diskutuar në një tubim publik ku nuk ka pasur mundësi që të marr pjesë?

Në çdo tubim publik duhet të mbahet procesverbali i cili përmban hollësi të të gjitha informacioneve të ofruara nga komuna, të propozimeve të parashtruara nga publiku, përgjigjet e komunës, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet. Një kopje e të gjitha përgjigjeve me shkrim duhet t'i bashkangjitet procesverbalit të tubimit.

A informohen zyrtarët dhe anëtarët e Asamblesë të cilët nuk kanë marrë pjesë në tubimin publik lidhur me diskutimet që janë zhvilluar dhe propozimet që janë parashtruar në tubimet publike?

Po. Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit Komunal brenda 60 ditësh nga dita e përfundimit të tubimit duhet ta shqyrtojë procesverbalin e çdo tubimi. Komiteti do ta analizojë çdo propozim të parashtruar në tubim publik. Në mbledhjen e radhës së Kuvendit Komunal, Komiteti do të dalë me rekomandime lidhur me propozimet e parashtruara.

8. Përgjegjësit dhe detyrat e zyrtarëve lokal për procesin vendimmarrës

Korniza e detyrave që zyrtarët lokal duhet ti kryejnë, do të mund të përshkruheshin më qartë, nëse integrohet logjika e përgjegjes në pyetjet si:

Pse duhet inkurajuar qytetarët për pjesëmarrje në procesin e konsultimit publik?

- Për të zhvilluar bazë të pasur të shënimeve. Vetëm qytetarët lokal dijnë më së miri nevojat dhe çështjet e komunitetit.
- Për edukim edhe të qytetarëve dhe politikbërësit për shumëdimensionin e problemit të komunitetit
- Për të siguruar diskutimin e problemit nga shumë këndvështrime dhe krijimi i hapsirës së dëgjimit të zërit të qytetarit.
- Bëhet më e lehtë implementimi i vendimit apo politikës së prodhuar nga autoritetet lokale.
- Ndihmon ndërtimin e konceptit të llogaridhënies edhe tek zyrtarët e pushtetit por edhe të qytetarëve.

Për një qëndrueshmëri të konsultimit publik, është e nevojshme të krijohen apo të funksionalizohen disa instrumente që ndihmojnë atë. Janë të njohura përvojat nga vendet tjera me demokraci më të avancuar por edhe ato nga vendet në tranzicion. Në Kosovë pse jo duhet eksploruar disa prej tregimeve të sukseshme nëpër komuna ku shoqëria civile gjegjësisht OJQ-të kanë krijuar forume dhe grupe gjithëpërfshirëse të cilat kanë demonstruar angazhime dhe kontribute në proceset vendimmarrëse.

Edhe pse fillimisht kanë qenë shumë të varura nga donatorët, autoritetet lokale do të mund të shfrytzojnë ndihmën dhe kontributin e këtyre strukturave përmes ndërtimit të partneritetve publike me interes reciprok.

Disa prej tyre janë:

Grupet e fokusit: grup qytetarësh që i bashkon interesi publik, që dijnë, kanë dije dhe mund të artikullojnë dhe adresojnë problemet e komunitetit ku jetojnë.

Forumet e Debatit: grup qytetarësh përfaqësues të subjekteve politike, sektorit të biznesit, OJQ-ve, profesionistë, organizatave vullnetare, qytetarë me autoritet të cilat problemet e artikulluara nga grupet e fokusit i transformojnë në çështje si emruar të përbashkët i problemit që prek komunitetin në nivel lokal.

Grupet për vendimmarje racionale: grup qytetarësh përfaqësues të qeverisë lokale, Kuvendit Komunal, sektorit të biznesit, OJQ-ve, profesionistë edhe nga niveli qendror me përgatitje profesionale konform çështjes që debatohet, të cilët me diskutime nga këndvështrime të ndryshme do të japin sugjerime, ide dhe propozime tek autoritet lokale për zgjidhjen e çështjes së debatuar.

Normalisht se ruajtja e komunikimit dhe rendi i veprimit të këtyre grupeve ndihmon në ndërtimin e qëndrueshmërisë së procesit të konsultimit publik, si mekanizëm demokratik.

Fleksibiliteti dhe mundësia e involvimit të shumë qytetarëve nga entitete të ndryshme dhe me qëndrime e opinione diverse shton edhe më shumë rolin dhe pozitën e këtyre strukturave në gjithë procesin e konsultimit publik si parakusht për një proces vendimmarrës.

Zyrtarët lokal përpara se të vendsoin se cilët instrumentë do të përdorin duhet të pyesin vehten?

- Si doni të involvoni publikun?
- Deri në çfarë niveli të procesit vendimmarrës doni të involvoni publikun?
- Si do të siguronit anagzhimin e publikut në proces kur kjo kërkon kohë nga ata?

Pavarësisht nga përzgjedhja e juaj, për një pjesëmarje efektive të publikut, nga zyrtarët kërkohet:

- Të mbledhë kontributet e publikut nga disa apo të gjitha fazat e procesit vendimmarrës

- Të ofrojë qytetarëve informacione të mjaftueshme, edukim apo trajnim që ata të luajnë rolin kuptimplotë në procesin vendimmarrës
- Të japë mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në procesin e konsultimit publik dhe vendimarrës për të gjithë akterët që preken nga vendimi i caktuar
- Të ketë në detaje dhe në baza të rregullta të freskuar pasqyrën e nevojave, prioriteteve dhe preferencave të pjesëve të komunitetit
- Të krijojë dhe të facilitojë dialogun e qëndrueshëm dhe në vazhdimësi me komunitetin përmes diskutimit dhe shkëmbimit të informatave rreth çështjeve me rëndësi qoftë nga politika e qeverisjes lokale apo nga kërkesat e komunitetit
- Të shërbehet me instrumentet dhe mekanizmat më të mirë lokal që ndihmojnë dialogun dhe partneritetin me komunitetin si gazetat lokale, radiot dhe TV lokale, buletinat informativ, solemenitetet dhe ceremonit e ndryshme, etj.
- Të lejohet që prioritetet dhe strategjit e zhvillimit të shërbimeve komunale të mund të ndikohen, ndryshohen dhe ti përshtaten prioriteteve dhe shqetësimeve të komunitetit.
- Të krijojë shprehi në informimin kthyes tek komunitetit se si konsultimi i tyre publik ka ndikuar në politikë- bërjen dhe procesin vendimmarrës.
- Të ruajë dhe mirëmbajë lidhjet, komunikimin me grupet apo organizatat e komunitetit.

Por edhe qytetarët për të siguruar ndikimin e publikut në proceset vendimarrëse duhet që të jenë aktivë në vazhdimësi dhe jo vetëm atëher kur preket interesi i ngushte personal apo privat.

Kjo kërkon nga qytetarët që të:

- Në mënyrë periodike të vizitojnë ndërtesat publike të autoriteve lokale ku vendosen informatat, njoftimet dhe vendimet e trupave vendimarrëse qeverisës. Mëso çfarë vendime janë marrë apo që po përgatiten të merren dhe mund të ndikohen nga publiku.
- Të kërkojnë me letra dhe në kontakte me zyrtarë, informata llogaridhënie për punën dhe vendimet e tyre.
- Të marrin pjesë aktive në tubimet publike obligatore të autoriteteve lokale
- Të inkurajojnë miqtë dhe familjarët të ju bashkohen në këto aktivitete. Është shumë e njohur se qasja si grup është shumë më e fuqishme, kur qytetarët flasin me një zë, shumë më lehtë do të ndikojnë në vendimarrje. Zëri i njëjtë duhet të jetë rezultat i marrëveshjes apo koncesusit me anëtarët tjerë të grupit.

- Respekto procedurat e procesit vendimmarrës të krijuara nga autoritete qeverisëse lokale.
- Bëhu realist në qëllimin dhe dëshirat tuaja. Autoritetet lokale duhet të marrin vendim duke respektuar vullknetin dhe interesin e shumicës së komunitetit
- Kurrë mos e nënvleftëso forcën dhe mundësit tuaja si qytetarë dh anëtar I komunitetit.

9. Rezultatet e mundshme të konsultimit publik

Janë shumë benefite që rezultojnë nga procesi i konsultimit publik të cilat dëshmojnë së përfitimet janë të shumëta dhe ato reflektojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e qeverisjes lokale dhe në mirëqenien e qytetarit duke rritë shkallën e përgjegjësisë qytetare edhe ata që zgjedhin por edhe të atyre që zgjidhen. Kjo ndihmon kultivimin e shprehive dhe respektimin e parimeve demokratike të organizimit të shtetit dhe shoqërisë, që për Kosovën si vend në tranzicion të formësimit shtetëror do të krontribojë në perspektivën afatgjatë.

Për të njohur më mirë shkallën e përfitimeve, përmes skemës së krahasimit të shikuar nga prizmi i akterëve kryesore të konsultimit publik, kemi paraqitur përfitimet kryesore.

- Vendimmarrësit/Autoritetet lokale/ qeverisje e mire, legjitime, politika dhe shërbime për qytetarë që plotësojnë kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, transparente, llogaridhënie, menaxhim korrekt dhe të drejtë të parasë publike, etj
- Qytetarët/ Komuniteti/ krijojnë komunikim me qeverinë, qasje për ndikim në vendimmarrje, kulturë për të monituruar qeverisjen, përmirësim të kushteve të jetës dhe punës, mundësi e kërkesës së llogaridhënies nga qeveria, planifikim të drejtë zhvillimor për komunitetin.

Vendimmarrësit	Qytetarët
<p><i>Përmirësimi i politikave dhe shërbimeve:</i></p> <p>Anagzhimi dhe konsultimi sjell informatën dhe dijen nga dora e parë për nevoja të politikës dhe shërbimeve. Qytetarët lokale dhe shërbyesit e shërbimeve në të shumtën e rasteve mund të sjellin perspektiva të ndryshme për problemet.</p>	<p><i>Niveli i lartë i besimit:</i></p> <p>Pjesëmarrja e komunitetit në konsultim ndihmon që të zhvillohet besimi, mirëkuptimi, legjitimiteti, bashkëpërgjegjësia dhe pronësia në proces.</p>
<p><i>Vendimet me interes publik:</i></p> <p>Vendimet politike dhe shërbimet do të reflektojnë më mirë dhe do të jenë në harmoni me nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesëve të shërbimeve dhe qytetarëve.</p>	<p><i>Kulturë qytetare:</i></p> <p>Të jesh i ftuar dhe të marrësh pjesë në konsultimin publik mund ti inkurajon dhe i fuqizon njerëzit të zhvillojnë shkathhtësi dhe interes për të qenë qytetarë të njohur ne komunitet.</p>
<p><i>Përmirësimi i llogaridhënies dhe transparencës:</i></p> <p>Pjesëmarrja e komunitetit rrit presionin dhe nevojën për qeverisje transparente dhe të hapur karshi publikut.</p>	<p><i>Gjithëpërfshirja:</i></p> <p>Pjesëmarrja e komunitetit është rruga e hapjes së procesit vendimarrës për të gjitha pjesët e komunitetit. I lejon njerëzit të vendosin prioritet, Lejon të ndërtohen rrjete dhe koalicione sociale/.</p>
<p><i>Kursimi në kohë dhe buxhet:</i></p> <p>Informatat korrekte dhe të sakta nga qytetarët dhe shfrytëzuesit e shërbimeve mund të ndihmojnë që most të merren vendime të gabuara dhe jopopullore. Kjo i mundëson autoriteteve që të shfrytëzojnë sa më mirë buxhetet e tyre dhe conform nevojave..</p>	<p><i>Fuqizimi i demokracisë:</i></p> <p>Ndërton sensin se demokracia është diçka që cdokush mund të jetë dhe duhet të merr pjesë në të. I lejon njerëzit të flasin për atë që i prek ata.</p>

Fig.3. Tabela e krahasimit të përfitimeve nga procesi i konsultimit publik

10. Vendimmarrja- finalizimi i konsultimit publik

Akti i vendimmarjes i bazuar në konsultimin publik është sintezë e kontributit dhe ndihmës së shumë akterëve të shoqërisë, që i bashkon interesi public, interesi për pjesën më të madhe të komunitetit. Është detyrë e autoriteteve qeverisëse se si do të integrojnë dëshirën e individët dhe kërkesat e publikut në agjendën dhe politikat qeverisëse. Preferohet që rezultatet e konsultimit publik të diseminohen publikisht dhe zyrtarisht duke krijuar hapësirë për analiza dhe komente edhe nga ana e autoriteteve dhe nga pjesët tjera të komunitetit që nuk kanë qenë të angazhuara për arsye të ndryshme në process. Kjo ndihmon edhe në inkluzivitetin e të gjithë akterëve të shoqëris dhe racionalitetin e vendimmarjes. Pas kohës së lejuar për komente dhe reshikim të propozim vendimeve, autoritetet lokale kalojnë në procesin formal të marrjes së vendimeve. Në situatat e caktuara kur në Kuvendet Komunale janë prezente tensione dhe fërkime midis subjekteve politike, procesi i vendimmarjes i bazuar ne konceptin e konsultimit publik ndihmon në ndërtimin e konncencusit politik me cka sigurohet implemtimi dhe respektimi i vendimmarjes.

11. Shtojca: Parimet e Qeverisjes së mirë

Transparenca	Proceset e vendim marrjes dhe institucionet publike duhet të jenë transparente, d.m.th. krahasimi i kostos (çmimit) për prodhimet individuale dhe shfaqja.
Pjesëmarrja	Pjesëmarrje e gjerë që rezultatet e politikës të kenë një besim më të madh, më të afërta me procesin dhe rezultate më kualitative.
Trajtim i barabartë	Ndalimi i diskriminimit të grupeve në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, etnike apo shoqërore, lidhja me ndonjë bashkësi kombëtare, pronës, lindjes, paaftësisë, gjendjes familjare, shtatzënësisë, orientimit seksual, apo moshës.
Llogaridhënia	Përgjegjësia për cilësinë e shërbimeve, efikasitetin, qëndrueshmërinë etj. për palët e interesuara.
Efektiviteti	Duhet të përmbushen kërkesat dhe duhet të zgjidhen problemet duke u bazuar në objektivitet dhe vlerësim.
Koherenca	Politikat dhe veprimet duhet të përputhen dhe të jenë koherente; veprimet politike dhe administrative duhet të jenë të bashkërenduara; masat e kualifikimit duhet të përputhen me rezultatet përkatëse.
Qëndrueshmëria	Vlerësimi i efekteve të veprimeve publike në afat të gjatë, zakonisht duke përfshirë aspektet ekonomike, shoqërore dhe ekologjike.
Vlerësimi	Zbatimi i të gjitha parimeve të renditura duhet të vlerësohet në baza periodike.

Pjesëmarrja e qytetarëve është vendimtare për Vetëqeverisjen Lokale

- Autoritetet lokale duhet t'u përgjigjen nevojave të qytetarëve.
- Qytetarët më së miri e dinë se cilat janë problemet dhe nevojat e tyre.
- Qytetarët mund të ofrojnë zgjidhje të cilat janë më të përshtatshmet për ta.
- Qytetarët ndihen të nderuar kur marrin pjesë dhe kanë mundësinë të japin mendimin e tyre.

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

**Rr."Rexhep Mala",
Nr.12 Prishtinë, Kosovë**

Tel: 038 245-734;

Fax: 038 245-733

E-mail: info@komunat-ks.net

Web: www.komunat-ks.net
